



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prilimjen/Prodato Received/Delivery	07.05.2021	viti god year	
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKIMSHICK	2287/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.199/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.199/2021 të datës 29.03.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi: Lagjja Iliria, banesë kati VII Nr.704, Ferizaj, kundër organit të punësimit Institucioni i Avokatit të Popullit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 47 dhe 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.199/2021 të datës 29.03.2021, të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja në datë 29.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protolli 1444/2021 të regjistruar me numër A.nr.193/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit elektronik të datës 25.03.2021 të Zyrës së Personelit të Institucionit të Avokatit të Popullit, përmes të cilit ankuesja është njoftuar se nuk është kualifikuar për në listën e kandidatëve që i nënshtrohen procesit të intervistimit, për zgjedhjen e “Zëvendës Avokatëve të Avokatit të Popullit.”

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.04.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Institucioni i Avokatit të Popullit. Ndërsa Këshilli me datë 12.04.2021, ka pranua nga Institucioni i Avokatit të Popullit përgjigjen në kërkesë me numër protokolli: 1711/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1444/2021 të datës 29.03.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur



Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin për zgjedhjen e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit; Rregulloren Nr.01/2015 për Mënyrën e Konkurrencës, Procedurën e Zgjedhjeve të Propozimit të Listës me Emrat e kandidatëve për Zëvendës të Avokatit të Popullit; Emailin e datës 25.03.2021 dërguar nga Zyra e Personelit për ankuesen; Diplomën e ankueses me numër Nr.2683 të datës 14.07.2021; Letrën motivuese të ankueses; CV-në e ankueses; Kartelën e punëtorit me numër:30085 lëshuar nga KEDS për ankuesen; Vërtetimin e datës 04.06.2021 me numër Nr.60/2020; Çertifikatën e shtetësisë së ankueses e datës 08.06.2020; Vërtetimin e lëshuar nga Policia e Kosovës me numër rendor:584/2020 të datës 15.06.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.04.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 12.04.2021; Emailin e datës 31.03.2021 dërguar nga Zyra e Personelit për ankuesen; Parashtrësën me numër protokollit 1829/2021 të datës 16.04.2021, Ankesën e parashtruar në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione të datës 16.04.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.199/2021 të datës 29.03.2021, të parashtruar nga ankuesja *sepse:*

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se Institucioni i Avokatit të Popullit me datë 29.01.2021, ka publikuar konkursin për përzgjedhjen e 5 (pesë) Zëvendësve të Avokatit të Popullit, ndërsa bazuar në përgjigjen në kërkesë të datës 12.04.2021 të Institucionit të Avokatit të Popullit, është konstatuar se ankuesja ka aplikuar në konkursin e lartcekur dhe se e njëjta përmes emailit të datës 25.03.2021 të Zyrës së Personelit të Institucionit të Avokatit të Popullit, është njoftuar se nuk është kualifikuar për në listën e kandidatëve që i nënshtrohen procesit të intervistimit, për zgjedhjen e "Zëvendës Avokatëve të Avokatit të Popullit". Kundër këtij Njoftimi ankuesja parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyratë Publike përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 ku është përcaktuar se: 1. Ky ligj nuk zbatohet për: 1.1. *Funksionarët publikë dhe* 1.2 *Funksionarët publikë me status të veçantë;* 3. *funksionarë publikë në kuptimin e nënparagrafit 1.1 të këtij neni, janë: funksionarët e emëruar nga Kuvendi apo nga Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura",* si dhe bazuar në Ligjin Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit respektivisht nenin 10 paragrafi 1 dhe 6 ku është përcaktuar se: 1. *Zëvendësit e Avokatit të Popullit i zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë;* 6. *Zëvendësit e Avokatit të Popullit zgjedhën nga Kuvendi, me mandat tre (3) vjeçar me mundësi rizgjedhjeje,* Kolegji ka konstatuar se Zëvendësit e Avokatit të Popullit janë funksionarë publikë dhe si të tillë janë të përjashtuar nga zbatimi i legjislacionit të shërbimit civil.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin si dhe pas konstatimit së Zëvendësit e Avokatit të Popullit nuk janë shërbyes civilë, Kolegji vlerësoj se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.199/2021 e datës 29.03.2021 të parashtruar nga ankuesja

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.199/2021

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretari i Institucionit të Avokatit të Popullit;
- Udhëheqësit të Personelit në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;



Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

